REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 934/20
Datë/Datum. 27.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica; G. Bellanica	18.11.2020	27.11.2020	934/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 00.11.2020 OE **"AGRIUM" SH.P.K –Ferizaj** ka parashtruar ankesë me nr: 934/20,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizimi me kontinjer dhe shporta të mbeturinave**" , me nr. të prokurimit: **622-20-6592-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Prizren.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **120 000,00** €.

Data e njoftimit për kontratë.....19.10.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim .....03.11.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....03.11.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE **"AGRIUM" SH.P.K – Ferizaj**

Dispozitat e shkelura

Neni 7 te LPP Nr. 04/L-042!
Neni 27 te LPP Nr. 04/L-042!
Neni 28 te LPP Nr. 04/L-042!
Neni 18 te RRUOPP-së
Neni 20 te RRUOPP-së
Neni 69.2 te LPP Nr. 04/L-042!

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Pretendimi 1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-se pasi qe gjate hartimit te dosjes se tenderit dhe hartimit te specifikimeve teknike ka vendosur kritere kufizuese dhe shume strikte pa ndonjë interval të plotësimit të tyre, te cilat qarte shihet se ia ka përshtatur një prodhimi ose OE te caktuar. Po ashtu ka vendosur kritere tjera diskriminuese dhe kufizime të panevojshme që shumicës së OE ia pamundësojnë pjesëmarrjen në këtë tender. Ky veprim i AK bie ndesh me nenin 7 te LPP-së si dhe bie ndesh edhe me nenin 27, 28, dhe 69.2 të LPP-së që flasin për procedurat e prokurimit për furnizime sepse ka bere favorizim të produkteve te caktuara, kufizime të panevojshme gjeografike dhe sociale që haptazi shihet se ka favorizuar edhe OE të caktuar që janë përfaqësues te produkteve te tilla. Krejt kjo konsiderohet favorizim i OE dhe njëkohësisht edhe diskriminim i të tjerve që bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së.
Pikat dhe kriteret kufizuese do ti përshkruajmë tek pretendimet tjera që lidhen drejt për drejt edhe me nenet e LPP-së që janë shkelur.

Pretendimi 2. AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 18 te RROUPP-se pasi që gjatë hartimit te dosjes se tenderit ka vendosur kritere dhe kërkesa diskriminuese dhe ne te njëjtën kohe favorizuese për OE te caktuar. Kriteret dhe kërkesat diskriminuese dhe të panevojshme që nuk i përgjigjen fare llojit të kontratës, po i renditim si më poshtë:

Kërkesa e parë diskriminuese nga dosja e tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe profesional** **Kërkesa 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 150.000,00 €.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve.**

Këtu si kriter i panevojshëm dhe i kundërligjshëm konsiderojmë se është kërkesa për të dorëzuar kontratat e nënshkruara e cila bie ndesh me interpretimin e KRPP-së në të cilin shumë qartë është cekur se kontratat për projektet e realizuara nuk duhet kërkuar nga OE për dorëzim në formën elektronike. Mjafton lista e kontratave dhe referencat që të dëshmohen projektet e realizuara në tre vitet e shkuara andaj dorëzimi i kontratave vetëm sa e ngarko sistemin e prokurimit elektronik. Kjo kërkesë përpos që bie ndesh me interpretimin e KRPP-së, bie ndesh edhe me nenin 69.2.1 të LPP-së.

Kërkesa e dytë diskriminuese nga dosja e tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe profesional** **Kërkesa 3. Të ketë së paku 4 të t për realizim të kontratës.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmi 3 Lista e të punësuarve e paraqitur ne ATK ne tre muajit e fundit bashkë me përshkrimin e shkurtër te vendit te punës. , përshkrimi i shkurtër i vendit të punës për stafin e rregullt , për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.**

Kjo kërkesë po ashtu është e panevojshme sepse kemi të bëjmë me një kontratë për furnizim ku furnizimi është i përnjëhershëm i cili mundet me u krye brenda ditës. Shtrohet pyetja, pse iu dashka AK të bëjë kufizime të tilla duke kërkuar përshkrim të vendit të punës dhe dëshmi që këta punëtor të jenë të lajmëruar tre muaj më herët në ATK. Si do veprohet po që se do të aplikoj një kompani e huaja e cila nuk ka fare të regjistruar biznesin në Kosovë.

Bazuar në këtë konsiderojmë se kjo kërkesë është e panevojshme dhe vetëm sa e rrit koston operative të kompanive tenderuese të cilat më pas atë e zbatojnë në çmimin e tenderit. Edhe më të pakuptimet e bënë këtë kërkesë fakti se kjo është kontratë për furnizim ndërsa në kushtet e veçanta të kontratës nuk ka ndonjë përshkrim apo shënim mbi formën e realizimit të kontratës. Aç më pak që gabimisht tek kushtet e veçanta është cekur se gjoja kërkohet programi për realizimin e punëve i cili duhet të zgjas sipas AK-së 15 ditë. Askund nuk thuhet se çfarë punësh do të kryhen dhe me që nuk ceken askund atëherë konsiderojmë se numri prej 4 punëtorëve të lajmëruar tre muaj më përpara në ATK përbënë një kufizim, sidomos për kompanitë e huaja që vijnë nga shtetet tjera dhe për kompanitë që operojnë më shumë si përfaqësues të kompanive të huaja. Shtrohet pyetja, me që kjo është kontratë për furnizim dhe nuk ka askund ndonjë program të veçantë të kryerjes së furnizimit, si do ta vlerëson AK një kompani psh. nga Shqipëria e cila ka punëtor por që nuk i ka të lajmëruar tek Administrata Tatimore e Kosovës.

Pra bazuar në llojin e kontratës, kërkesa e tillë është plotësisht e panevojshme dhe diskriminuese sidomos për kompanitë që merren vetëm me furnizime, ato që janë hapur jo më larg se tre muaj e që janë në konzorcium me prodhuesin, apo që vijnë nga ndonjë shtet tjetër.

Kërkesa e tretë diskriminuese nga dosja e tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **Kërkesa 4. Të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike 1 kamion të tonazhit deri 5 ton- pesha ngarkuese.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 4. a, - pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, Dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet te dëshmohet me kontratë. Dëshmia 5 OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te na sjell deklaratën e selisë per piken e shpërndarje së furnizimit.**

Kërkesa nga sqarimi i dosjes së tenderit:

3. OE pjesmarrës në këtë tendwer duhet të na dëshmoj se ka në pronësi ose posedim së paku një mjet transportues deri në 5 ton bartje me të cilin do ti bartë pajisjet e kërkuara.

Edhe kjo kërkesë është e panevojshme dhe diskriminuese sepse produktet që do të furnizohen zakonisht vijnë nga vendet tjera pasi që nuk ka prodhues të tyre tek ne, andaj pse u dashka që një here artikujt të shkarkohen nga maunat transportuese (shleperët apo kamionët transportues) dhe të liferohen tek AK përmes kamionit 5 tonësh. Përpos kësaj kërkesa është pak sa e pa saktësuar mirë sepse nuk dihet se a duhet të ketë kamioni peshën bartëse minimum 5 ton, apo lejohet të ketë peshën edhe më të vogël se 5 ton. Bazuar në kërkesën që thotë deri në 5 ton, dikush mundet të mendojnë se mjaftojnë edhe kamionët me peshë bartëse 4.5 ton e që sipas definimit të AK e plotëson kushtin **deri në 5 ton**. Këtu shtrohet pyetja: a pranohet edhe kamioni me peshë bartëse 500 kg e që e plotëson kushtin e peshës bartëse deri ne 5 ton por që realisht mundet ti bart vetëm 10 kontejnerë. Bazuar ne këtë mendojmë se kjo kërkesë përpos që është e panevojshme sipas llojit dhe përshkrimit të kushteve të kontratës, është edhe jo e definuar mirë dhe nuk lejon asnjë interval psh. të ceket: **pesha e lejuar 4-6 tonë dhe të ceket a bëhet fjalë për peshën *bartëse* apo *totale.***

Pse u dashka të kufizohet pesha kur kjo është kontratë një furnizimshe dhe produktet e tilla vijnë nga jashtë vendit që nuk mundesh me ua kufizua OE mënyrën e transportimit të tyre.
Po që se ka ndonjë program të shpërndarjes atëherë duhet të përshkruhet tek kushtet e veçanta e jo të lihet kështu e pa definuar e më pas të ndryshohen format dhe mënyra e shpërndarjes sepse krejt ajo përbënë një kosto shtesë për OE. Bazuar në këtë kërkojmë nga AK që ta largoj tërësisht këtë kërkesë sepse sipas gjendjes së dosjes së tanishme dhe të llojit të kontratës është e panevojshme.

Kërkesa e katërt diskriminuese nga dosja e tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe profesional** **Kërkesa 5. OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te ketë pikën e shpërndarjes së furnizimeve në qytetin e Prizrenit ose 5 km larg Prizrenit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 5 OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te na sjell deklaratën e selisë per piken e shpërndarje së furnizimit.**

Kërkesa nga sqarimi i dosjes së tenderit:

4. OE I propozuar për kontratë duhet të sjellë dëshmi se ka në pronësi ose shfrytëzim një pike në komunën e Prizrenit nga e cila do të bëhet shpërndarja e këtyre kontejnerëve. Në asnjë formë kjo nuk është diskriminuese për OE ndërsa është në favor të qytwetarëve të cilëve do të iu shpërndahen këta kontejner.

Edhe kërkesa që OE duhet të ketë në pronësi një depo në komunën e Prizrenit nga e cila sipas AK-së do të bëhet shpërndarja, është kërkesë tejet diskriminuese dhe absolutisht e panevojshme. Në dosjen e tenderit shumë qartë shkruan se kjo është kontratë për furnizim dhe liferimi do të filloj 3 ditë pas nënshkrimit e që mundet me zgjatë deri në 15 ditë. Pse u dashka të ketë depo kur kjo mund të bëhet direkt përmes kamionëve apo maunave që i sjellin këta kontejner nga vendet ku prodhohen. Nuk e kuptoj pse qenka në favor të qytetarëve posedimi i një depoje në Prizren, për të paguar qira ndonjë prizrenasi apo çka? Çka ka lidhje se a bëhet liferimi i produktit direkt nga dogana apo nga depoja e Prizrenit. Definitivisht kjo është një kërkesë që vetëm sa do ta rris koston e projektit për AK-në i cili këta kontejner i lenë me paranë e tatimpaguesve prizrenas. Pra nëse mendon ta rris koston e produkteve për vlerën e një qereje mujore të një depoje në Prizren, atëherë si mundet të quhet favor për qytetarin. Nga secili qytet i Kosovës mjaftojnë maksimumi 1.5 orë dhe kamioni me produkte të tilla arrijnë në Prizren, jo që kjo është kontratë për furnizim dhe zakonisht artikujt e tillë liferohen direkt nga pika doganore ku edhe është bërë zhdoganimi i tyre. Të mendohet se posedimi i një depoje në Prizren nga OE është favor për qytetarin, është hipokrizi e llojit të vet dhe shihet qartë se ky projekt është përgatitur për një kompani të caktuar e që si veprim konsiderohet shumë diskriminues dhe favorizues i cili është plotësisht në kundërshtim me nenin 7 dhe 69.2 të LPP-së. Krejt këtë e argumentojnë edhe më shumë kushtet e veçanta të kontratës ku askund nuk tregohet për formën e liferimit.
Pra kërkohet nga AK që të largohet kjo kërkesë e panevojshme dhe shumë diskriminuese sepse si e tillë vetëm sa e dëmton buxhetin e komunës duke e shpenzuar paranë e taksapaguesve në kundërshtim të plotë me nenin 6 të LPP-së

Kërkesa e pestë diskriminuese nga dosja e tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe profesional** **Kërkesa 6. OE qe ofertojnë duhet ti sjellin mostrat me shenjat e OE para hapjes së ofertave ne KRM " Ekoregjion" ne Prizren – rruga Tahir Sinani nr. 59**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Kërkesa nga sqarimi i dosjes së tenderit:

5. Për tu trajtuar oferta juaj në mënyrë të barabart me ofertat tjera jeni të obliguar që ti sjellni mostrat e kërkauar në adresën e caktuar jo më von se 15 minuta para hapjes së ofertave. Kjo situate është e rregulluar me LPP dhe RRUOPP. Arsyeshmërin që të sillen ose jo mostrat e vlerësojmë ne e jo ju.

Kërkesa që të sillen mostrat e tre kontejnerëve të bërllogut me gabarite mbi 1 m³ është një kërkesë tepër e panevojshme dhe që e ngrit dukshëm koston e projektit. Paramendo sa kushton me sjellë një mostër të tillë nga Italia, Austria apo Greqia. Krejt kjo kosto do ti ngarkohet AK-së në çmimin tenderues. Sipas rregullave të prokurimit publik mostrat duhet kërkuar zakonisht për produkte që nuk kanë katalogje apo vizatime teknike të cilave duhet të iu përmbahen OE. Është plotësisht e pa arsyeshme të kërkohet një mostër e një produkti me gabarit mbi 1m³ i cili është i standardizuar, posedon certifikatën e prodhimit, posedon formën standarde të dukjes që është treguar përmes vizatimeve teknike, posedon peshën, trashësinë e materialeve përbërëse,

ngjyrën dhe krejt çka është e nevojshme për një verifikim gjatë pranimit teknik.
Të gjithë kontejnerët e Evropës posedojnë standardin EN 840 të cilin e ka cekur edhe AK tek specifikimi teknik dhe posedojnë certifikimin ISO 1461, andaj pse u nevojitka mostra kur AK nuk ka asnjë laborator apo mjet të matë kualitetin e sajë.
Shihet qartë se këto kërkesa janë favorizim për një OE të caktuar i cili i posedon mostrat e
tilla ne stok dhe në të njëjtën kohë është shumë diskriminuese për OE që nuk i kanë mostrat e tyre në stok e sidomos për ata OE që janë nga shtetet tjera që na rrethojnë. Aq më të pa arsyeshme këtë kërkesë e bën edhe emri i markës së produktit të cekur nga AK (**PG&GP**) që tregon se këtë projekt janë munduar të ja përgatisin një OE të caktuar. Bazuar në këtë, kjo kërkesë duhet larguar dosja e tenderit sepse nuk i përgjigjet natyrës së artikullit dhe nuk i përgjigjet as shfrytëzimit të parasë publike në mënyrë efikase dhe efektive sipas nenit 6 të LPP-së.

Pra bazuar në krejt këtë që e theksuam më lartë shihet se vendosja e kritereve të tillë e shtyn AK drejt shkeljes se nenit 27 te LPP dhe 18 te RROUPP ku sipas tyre AK e ka te ndaluar vendosjen e kritereve kufizuese(citoj nenin 18 te RROUPP) - ***"Është e ndaluar përgatitja e Dosjes së Tenderit në një mënyrë që favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë Operatorëve Ekonomik potencial".***
Të gjitha nën dispozitat e këtyre dy neneve i kërkojnë AK-së qe te hartoj dosje te tenderit gjithë përfshirëse dhe jo kufizuese andaj kërkesat e AK-së bien plotësisht ne kundërshtim me kërkesat e këtyre neneve.
AK kishte pranuar disa pyetje dhe kërkesa për sqarim nga një OE i interesuar dhe të njëjtit iu është përgjigjur ku dokumentin me pyetjet dhe përgjigjet e kishte publikuar në e-prokurim. Përgjigja e AK-së për neve jo që është e pamjaftueshme dhe e kundër ligjshme, por është një përgjigje skandaloze që e pasqyron shumë qartë interesin e AK për dhënien e kësaj kontrate një OE të caktuar dhe të parazgjedhur nga ata. Sa për ilustrim po ua paraqesim edhe këtu ndërsa si t plotë e gjeni të bashkangjitur kërkesës tonë

Date: 21.10.2020

Projekti: Numri i Prokurimit: **622-20-6592-1-2-1**– Titulli **Furnizimi me kontejner dhe shporta të mbeturinave**

Lenda: Kerkese per lejimin e tolerances ne dimensione dhe largimin e kritereve diskriminuese

Kerkojme nga AK Prizren, qe te lejoje tolerance ne specifika me min ± 5% dhe te largoje kriteret dikskriminuese dhe qe jane ne kundershtim me LPP-ne per projektin ne fjale .

Kriteret diksriminuse jane:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional . **Kërkesa 4. Të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike 1 kamion të tonazhit deri 5 ton- pesha ngarkuese. Kërkesa 5. OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te ketë pikën e shpërndarjes së furnizimeve në qytetin e Prizrenit ose 5 km larg Prizrenit.** **Kërkesa 6.** **OE qe ofertojnë duhet ti sjellin mostrat me shenjat e OE para hapjes së ofertave ne KRM " Ekoregjion" ne Prizren –rruga Tahir Sinani nr. 59**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 4. a, - pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, Dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet te dëshmohet me kontratë.** **Dëshmia 5 OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te na sjell deklaratën e selisë per piken e shpërndarje së furnizimit.**

Arsyetim:

AK duhet te veproje ne pajtim te plote me NENIN 28 te mos kufizoje dimensione pasi qe kjo tregon qarte se specifikat teknike I jane pershtatur nje prodhuesi dhe kufizon pjesemarrjen e OE dhe njekoheishte favorizon nje OE te caktuar !?

Kerkesa nr 4. Eshte krejtesishte e pa nevojshme sepse AK e ka te qarte se behet fjale per produkt qe nuk prodhohet ne Kosove dhe krejt ne fund AK ka kerkuar qe furnizimi te behet ne adresen e caktuar dhe kjo kerkese eshte vetem sa per ngarkuar OE te lidhe nje kontrate shfrytezimi me nje transportues sa per deshmi letre sepse nje transport I tille eshte krejtesishte I pa perdorshem!?

Kerkesa e 5. Eshte krejtesishte ne kundershtim me ligjin pasi qe kufizon territorin e OE, nje kerkese e tille eshte krejtesishte e pa nevojshme per nje kontrate te furnizimi e cila nuk ka te beje fare me ndonje kosto shtese apo qeshtje tjeter qe e ngarkon AK . Kjo kerkese tregon hapur se AK I ka pershtatur kriteret per nje OE nga Prizreni dhe kjo normalishte qe eshte bere me vetedije te plote nga AK dhe konisderohet shkelje me qellim dhe per kete e kemi njoftuar KRPP-ne dhe AKK-ne

Kerkesa Nr 6. Nje kerkese e tille per mostra eshte tejet e pa arsyshme per faktin qe jane dhene skicat e produktit , specifikat teknike te detajuara andaj dhe kjo kerkese eshte vetem kosto per ne si OE dhe kjo kerkese konsiderojme se eshte vendosur me qellim te vetem te ul konkurrencen duke favorizuar OE qe vetem ka keto produkte ne stok .

Presim mirekuptimin tuaj !

Me respekt

Be New LLC

Prishtine

Kjo ishte pyetja sqarues ndërsa më poshtë po ua paraqesim përgjigjen e AK-së:

Përshëndetje. Fillimisht ju duhet të luani rolin e OE të interesuar për të marr pjesë në tender e jo rolin e policit ose të hetuesit e kërcënuesit sepse për këto nuk keni të drejt bash hiq.

1. Asnjë kriter I vendosur nuk është as diskriminues e as favorizues për asnjë O. të gjith pjesmarrësit janë të barabart dhe mund të aplikojnë në kushte të barabarta. Nuk keni nevoj hiq të na I përmendni as KRPP e as AKK e as kurfar organi hetues në lidhje me këtë project.
2. Ju duhet ti përmbaheni kërkesave të vendosura në DT dhe në NJK
3. OE pjesmarrës në këtë tendwer duhet të na dëshmoj se ka në pronësi ose posedim së paku një mjet transportues deri në 5 ton bartje me të cilin do ti bartë pajisjet e kërkuara.
4. OE I propozuar për kontratë duhet të sjellë dëshmi se ka në pronësi ose shfrytëzim një pike në komunën e Prizrenit nga e cila do të bëhet shpërndarja e këtyre kontejnerëve. Në asnjë formë kjo nuk është diskriminuese për OE ndërsa është në favor të qytwetarëve të cilëve do të iu shpërndahen këta kontejner.
5. Për tu trajtuar oferta juaj në mënyrë të barabart me ofertat tjera jeni të obliguar që ti sjellni mostrat e kërkauar në adresën e caktuar jo më von se 15 minuta para hapjes së ofertave. Kjo situate është e rregulluar me LPP dhe RRUOPP. Arsyeshmërin që të sillen ose jo mostrat e vlerësojmë ne e jo ju.

Po ashtu edhe një tjetër OE ka bërë ankesë për kufizime dhe kërkesa favorizuese ndërsa AK i ka kthyer një përgjigje shumë të çuditshme. Po e bashkëngjisim këtë përgjigje të AK sa për ilustrim për të treguar vendosshmërinë e AK për ta favorizuar një produkt dhe një OE të caktuar.

VENDIM

1. Refuzohet si e pa bazë kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të **"Pastor Kosova" SHPK e parashtruar lidhur me projektin "Furnizimi me kontejner dhe shporta për mbeturina"** të Prok: **622-20-6592-121** kundër ***njoftimit për kontratë*** te AK –së, të **datës 20. 10. 2020** te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. Vërtetohet njoftimi për kontratë lidhur me këtë projekt

Arsyetim

Operatori Ekonomik **"Pastor Kosova" SHPK** me datë **.02. 11 2020**_, përmes platformës së eprokurimit ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me kontejner dhe shporta për mbeturina"** të Prok: **622-20-6592-121**

Autoriteti Kontraktues, me dat. **02. 11. 2020** , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa për rishqyrtim të refuzohet si e jpa bazuar duke pasë parasyshë këto fakte:

1. Nuk është as në detyrat e as në të drejtën tuaj të konstatoni se është ose nuk është e nevojshme vendosja e një kriteri ose kërkese të caktuar në DT dhe NJK. Kjo e drejt dhe obligim ligjor është i autoritetit kontraktues dhe ju si Oe duhet ti përmbaheni këtij kriteri
2. Kriteri për pikënn e shpërndarjes duhet të plotësohet sepse një sasi e kontejnerëve do të vijnë vet qytetarët e Prizrenit, dhe nuk dij ça do të ishte e arsyeshme që ti thujet qytetarit se i është ndarë një kontejner por ate do të shkoj ta marrë në Podujevë psh.
3. Për të mos ra viktim e mashtrimeve të cilat dijnë ti bëjnë OE pas nënshkrimit të kontratës dhe për ttë mos e lejuar nënshkruesin e kontratës që në vend të arrave të na sjellë gogla kemi kërkuar që paraprakisht të na i sjellni mostrat dhe furizuesi do të furnozoj me kontejnerët të cilët i ka sjellë si mostër. Kërkesa për mostrat është e rregulluar edhe me LPP dhe RRUOPP.
4. Siq edhe vet po e shihni asnjë kriter i vendosur në DT dhe nJK nuk është as favorizues as diskriminues e as i panevojshëm andaj te gjitha keto kritere mbeten dhe kërkohet nga ju që ti përmbushni për të qen nënshkrues i kesaj kontrate
5. Duke u mbështetë në këto fakte:

3. Autoriteti Kontraktues, vendos si në dispozitivin e këtij vendimi
Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Pra bazuar në përgjigjen e AK-së, bazuar në sqarimin që i bëmë secilit pretendim tonit për kërkesa diskriminuese dhe bazuar edhe në krahasimin e kërkesave të AK-së nga dosja e tenderit me llojin e kontratës që parashihet t nënshkruhet, nuk kemi se si të mos mendojmë ndryshe përveç se AK ka shkelur plotësisht nenin 27 të LPP-së, nenin 18 të RRUOPP-së si dhe nenin 69.2 të LPP duke aplikuar kërkesa plotësisht të panevojshme dhe favorizuese për OE të caktuar. Në vazhdim po u paraqesim edhe përgjigjen që AK na ka dhënë në refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim. Edhe kjo përgjigje ngjashëm sikur përgjigjja e më hershme është shumë e çuditshme sepse është e shkruar në atë formë sikur ta kish bërë një person që nuk e njeh fare prokurimin publik dhe mënyrën e komunikimit zyrtar.

Arsyetim

Operatori Ekonomik të **"AGRIUM" SHPK** me datë **.02. 11 2020_**, përmes platformës së eprokurimit ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me kontejner dhe shporta për mbeturina"** të Prok: **622-20-6592-121**

Autoriteti Kontraktues, me dat. **03. 11. 2020** , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa për rishqyrtim të refuzohet si e jpa bazuar duke pasë parasyshë këto fakte:

1. Nuk është as në detyrat e as në të drejtën tuaj të konstatoni se është ose nuk është e nevojshme vendosja e një kriteri ose kërkese të caktuar në DT dhe NJK. Kjo e drejt dhe obligim ligjor është i autoritetit kontraktues dhe ju si Oe duhet ti përmbaheni këtij kriteri. Asnjë kriter nuk është as diskriminues e as favorizues për asnjë OE, karakteristikat e prodhimeve jan marrë nga disa lloj prodhimesh dhe është përzgjedhë ajo që sipas autoritetit kontraktues është më kualitative. Forma se si kërkohen dëshmitë nuk ësht prap në kometencën tuaj por të AK së se si do ti kërkoj dëshmitë e caktuara.
   Në asnë vend nuk është përmend asnjë brend e asnjë emër i ndonjë prodhuesi eventual.
   Pothuaj se në të gjitha pretendimet jeni impikuar kot fare në interpretim të rregullave dhe mënyrës se si ne i kemi kërku këto dëshmi,
   Asnjë nga këto kërkesa dhe dëshmi NUK DO TË NDRYSHOJË.
2. Pesha e kërkuar për automjetin është pesha bartëse dhe kjo kërkesë mbetet e pandryshuar. Juve iu mbetet ta përmbushni ashtu siq është kërkuar.
3. Kriteri per pikën e shpërndarjes duhet të plotësohet nga OE i propozuar për kontratë dhe atë në formën siq është kërkuar në DT dhe NJK pa asnjë ndryshim sepse një sasi e kontejnereve do të vijnë vet qytetarët e Prizrenit, dhe nuk dij sa do të ishte e arsyeshme që ti thuhet qytetarit se i eshtë ndarë një kontejner por ate do të shkoj ta marrë në Kamenicë psh.
4. Për të mos ra viktim e mashtrimeve të cilat dijnë ti bëjnë OE, pas nënshkrimit të kontratës dhe për të mos e lejuar nënshkruesin e kontratës që në vend të duhanit të na sjellë dushk kemi kërkuar që paraprakisht të na i sjellni mostrat dhe furizuesi do të furnizoj me kontejnerët të cilët i ka sjellë si mostër. Kërkesa për mostrat është e rregulluar edhe me LPP dhe RRUOPP.
5. Siq edhe vet po e shihni asnjë kriter i vendosur në DT dhe nJK nuk është as favorizues as diskriminues e as i panevojshëm andaj të gjitha këto kritere mbeten dhe kërkohet nga ju që ti përmbushni për të qen nënshkrues i kësaj kontrate

Pikërisht duke u bazuar ne këtë përgjigje dhe duke dashur qe ta inkurajojmë edhe me shume AK-ne qe te rregulloj kriteret dhe kërkesat e dosjes se tenderit, iu kemi drejtuar edhe KRPP-se me një kërkese për monitorim. KRPP na ka informuar se ia kane tërhequr vërejtjen AK-se qe te merr për baze seriozisht kërkesat e LPP-se për mos diskriminimin e OE por këta te fundit akoma nuk kane ndryshuar konkretisht asgjë me përjashtim qe e kane shty afatin e tenderimit. Dëshminë lidhur me kërkesën tonë për monitorim dhe përgjigjen e AK-se e gjeni si të bashkangjitur kësaj ankese.

Pas krejt kësaj që sqaruam më lartë konkludojmë dhe pretendojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 27 të LPP-së por edhe nenin 108/A të LPP-së pasi që nuk i ka trajtuar askund për së afërmi pretendimet tona ashtu siç i kemi atakuar në kërkesën për rishqyrtim.

Pretendimi 3. AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së si dhe 20 të RROUPP-së pasi që gjatë hartimit të kërkesave tek specifikimi teknik ka vendosur kritere shume strikte duke favorizuar prodhime te caktuara dhe përfaqësues të caktuar të atyre prodhimeve.

LPP dhe RRUOPP shumë qartë e kërkojnë që:

"Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik."

Përpos kësaj AK e ka të ndalur që të ju referohet prodhimeve të caktuara, bendeve dhe shenjave të caktuara por edhe dimensioneve të caktuara strikte që nuk i japin as edhe një favor të mundshëm AK-së. Kërkesat që AK ka vendosur si kufizime dhe si kërkesa shume strikte tek specifikimi teknik kanë të bëjnë me të gjithë artikujt e kërkuar. Shihe ne vijim specifikimin teknik ku kufizimet e jashtë ligjshme dhe kërkesat diskriminuese janë të hijezuara me të verdhë

Modeli nr. 1
Kontejnerët nga çeliku i galvanizuar 1,1m3



DETAJET TEKNIKE					
Lloji i materialit	Pesha	Gjatësia A	Gjerësia B	Lartësia C	Lartësia D
Çelik i galvanizuar	125 kg 3%	1370 cm	1030	1415	1165

Modeli:	1100L-1
Emri i markës:	PG&GP
Trashësia e trupit:	1.5 mm
Struktura:	në këmbë
Trashësia e krahëve të kapakut:	3.00 mm
Mbulesa e trashësisë:	1,25 mm
Baza e rrotave:	4,00 mm
Mbulimi i Toleancës;	± 0,3 mm

Specifikimet tjera:

1. (1.1) M3 ± 5% i përshtatshëm për mbeturinat e prodhuara sipas EN-840
2. Trupi është çelik me galvanizim të nxehtë sipas ISO 1461 dhe kapaku është gjysëm harkor
3. Rrota: secili kontejner ka katër rrota të forta me diametër (200) mm, të vlerësuarat 360o për lëvizje të lehtë; dy prej tyre kanë frenim këmbë. Diametri: 200 mm
4. Vrima e kullimit: në pjesën e poshtme të kontejnerit ka vrimë kullimi dhe pastrimi të mbuluar nga plastika.
5. Goma gome të ngurta

Modeli nr. 2
Kontejnerët nga Plastika 1.1m3



DETAJET TEKNIKE					
Lloji i materialit	Kapaciteti	Pesha	Lartësia A	Gjerësia B	Gjatësia C
PVC - HDPE	1.1m³	50 / 46.5 kg +/- 5%	1470 cm	850	1090

Specifikimet tjera:

6. (1.1) M3 ± 5% i përshtatshëm për mbeturinat e prodhuara sipas EN-840
7. Trupi është PVC me elemente shtesë nga qelilau i galvanizuar , kapaku është gjysmë harkor dhe kapaku ndihmës gjysmë hapje.
8. Rrota: secili kontejner ka katër rrota të forta me diametër (200) mm, të vlerësuarat 360o për lëvizje të lehtë; dy prej tyre kanë frenim këmbë. Diametri: 200 mm
9. Vrima e kullimit: në pjesën e poshtme të kontejnerit ka vrimë kullimi dhe pastrimi të mbuluar nga plastika.
10. Goma gome të ngurta

Modeli nr. 3
Kontejnerët nga Plastika 120 litra





Vëllimi: 120 lit

Përmasat:	550x480x964
Pesha:	9.5 kg
Materiali:	HDPE (polietilen me densitet të lartë), UV
Rezistenca e temperaturës:	-30 C në +80 C
Rrotat:	2 rrota gome me rrota plastike
Elemente perforcuese	çeliku inox
Kapak	me dorezë

Nga specifikimi teknik shihet qartë se AK askund nuk ka përdorur mundësin minimum/ maksimum apo interval tek dimensionet. Këto dimensione as vet standardi përkatës EN-840 mbi bazën e të cilit edhe prodhohen këta artikuj nuk i kufizon në dimensione kaq strikte e po ashtu as në vendin tonë nuk ka ndonjë standard që kërkon diçka të tillë. Secili prodhues i këtyre produkteve i ka dimensionet e veta që janë shumë të përafërta me këto që AK ka vendosur tek Specifikimin Teknik por asnjë prodhues tjetër nuk i ka saktë ashtu siç i ka kërkuar AK sepse vet standardi EN-840 e lejon një gjë të tillë.

Mos dhënia e mundësisë me **minimum X mm, maksimum Y mm, përafërsisht XX kg** apo **përafërsisht Z mm** trashësi, apo mos vendosja e intervaleve psh: lartësia nga **X mm** deri në **Y mm,** e kufizon absolutisht konkurrencën dhe ia jep mundësin vetëm një prodhuesi të caktuar për ofertim në këtë tender. Kjo ndikon shumë negativisht edhe tek çmimi i tenderit pasi që kur prodhuesi e tillë e kupton se këtë tender mundet të konkurroj vetëm një OE që ai e ka autorizuar, atëherë vjen edhe deri te rritja e kostos për blerjen e tyre. Sipas hulumtimeve që ne kemi bërë në internet shihet së këto karakteristika mundet të i plotësoj vetëm një prodhues i caktuar, e sipas burimeve tjera që ne posedojmë, atë prodhues e përfaqëson një OE nga Prizreni.

AK ka përdorur madje edhe emrin e markës të kontejnerit (PG&GP) që është plotësisht e ndaluar të përdoret tek specifikimet teknike. Bazuar në këtë dhe në argumentet e ofruara të cilat pas krahasimit me dispozitat e LPP-se dhe RRUOPP-se shihet se AK ka krijuar specifikime teknike kufizuese dhe favorizuese për ndonjë OE të caktuar. Këto specifikime teknike munden të i plotësojnë vetëm dy prodhues të caktuar që AK i ka targetuar duke ua hequr mundësin e intervaleve secilit prej dimensioneve kryesore. Prodhuesit dhe artikujt që AK i ka targetuar duke i favorizuar janë ata të prodhuesit EUROPLAST nga Austria dhe PLASTIK GOGIĆ nga Serbia. Ja produktet që ne i kemi gjetur përmes internetit ë i përgjigjen saktë atyre të AK-së.

Produkti i EUROPLAST nga Austria.



Produkti i PLASTIK GOGIĆ nga Serbia

+381 (22) 561-674 ; +381 (22) 555-306 ; +381 (22) 552-141 office@plastikgogic.rs

PlastikGogić

Company Products News Download Contact En

Waste bin 120l Premium series

Home > Waste bin 120l Premiu

TECHNICAL DATA:

Volume: **120 lt**
Max load capacity: **60 kg**
Dimensions: **550 x 480 x 964 mm**
Weight: approx. **9,00 kg**

Material: They are made of (HDPE) High Density Polyethylene, UV-stabilized.
resistant to high and low temperatures
Wheels: 2 rubber wheels Ø200
Corrosion-free steel axle
Lip-handle lid
Lid with 3 handles

Technical specification PDF

CE EN 840

PlastikGogić

Company Products News Download Contact English



OPTIONS:

Recycling inserts for PET, paper, packaging and glass
Foot pedal
Chip nest
Locking system
Noise reduction
Marking
Hot stamping
Colors: green, yellow, blue, black, red, brown

DIMENSIONS:



Bazuar në këtë po shihet haptazi se kërkesat teknike por edhe ato kualifikuese i janë përshtatur këtyre prodhuesve përkatësisht OE të autorizuar nga ata në mënyrë që të jetë i vetmi që do të aplikoj në këtë tender. Nisur nga ky fakt shtrohet pyetja: pse AK nuk po e përdor procedurën negociuese (*direkte një burimore*) por

me shkelje ligjore po mundohet të i realizoj interesat e grupeve të caktuara që si veprim shkon drejtpërdrejt në dëm të buxhetit të shtetit dhe të keqpërdorimit të parasë publike të taksa paguesit.
Ne kërkojmë nga OSHP që ta detyroj AK-në që të largoj këto kufizimet dhe të lejon mundësin më të gjerë të tenderimit duke vendosur dimensione me intervale dhe me hapësirën që e lejon edhe vet standardi i prodhimit të kontejnerëve EN-840.
Bazuar në krejt këtë vijmë në përfundim se AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së dhe nenin 20 të RRUOPP-së gjatë hartimit të specifikimeve teknike.
Shikuar detalisht kërkesat e dosjes së tenderit, specifikimin teknik, sqarimet e ofruara nga AK, përgjigjen në ankesën e një OE, si dhe shikuar dhe krahasuar me kërkesat e ligjit, shihet se kjo dosje është e krijuar vetëm për një OE të caktuar. Kjo ndalohet rreptësishtë me nenin 7, 27 dhe 28 të LPP-së si dhe me nenin 18 dhe 20 të RUOPP-së.
Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që thamë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

V E N D I M
A P R O V O H E T si e bazuar ankesa e OE **"AGRIUM SH.P.K"** lidhur me tenderin **"Furnizimi me kontejner dhe shporta të mbeturinave"** i iniciuar nga **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
A N U L O H E T njoftimi për kontratë i **AK – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.** Detyrohet AK për të eliminuar kërkesat kufizuese nga dosja e tenderit e më pas të vazhdohet me procedurën në fjalë. Gjithashtu të rishikohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke i harmonizuar ato me LPP-në dhe RRUOPP-në si dhe duke ia përshtatur natyrës së projektit dhe shpenzimit efikas dhe efektiv të parasë publike.
Rishikimi i dosjes së tenderit të bëhet duke i aplikuar vetëm kërkesat ligjore që i parasheh LPP-ja dhe RRUOPP për rastet e kontraktimeve adekuate.

KRITERETPËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit
2. OE duhet të jetë i Regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH-së
3. Regjistrimi i Numrit Fiskal

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 240.000,00 €

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1 Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se

150.000,00 €.
2. Në kuadër të stafit duhet të Caktohet me vendim menaxheri i projektit i cili duhet të jetë me kualifikim të lartë (te ketë diplomë fakulteti).
3. Të ketë së paku 4 të t për realizim të kontratës.
4. Të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike 1 kamion të tonazhit deri 5 ton pesha ngarkuese.
5. OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te ketë pikën e shpërndarjes së furnizimeve në qytetin e Prizrenit ose 5 km larg Prizrenit.
6. OE qe ofertojnë duhet ti sjellin mostrat me shenjat e OE para hapjes së ofertave ne KRM " Ekoregjion" ne Prizren –rruga Tahir Sinani nr.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje).
2 Certifikata e TVSH-kopje.
3 Certifikata e numrit fiskal-kopje.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara nëAdministratën Tatimore të Kosovës.

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo process verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve.

2. Duhet te caktohet me vendimi menaxheri i projektit, diploma e menaxherit, dëshmi mbi kontratën e punës ose kontratën e bashkëpunimit për ketë projektë.
3. Lista e të punësuarve e paraqitur ne ATK ne tre muajit e fundit bashkë me përshkrimin e shkurter te vendit te punës. përshkrimi i shkurtër i vendit të punës për stafin e rregullt , për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt
4. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet te dëshmohet me kontratë.
5 OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te na sjell deklaratën e selisë per piken e shpërndarje së furnizimit.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

{Komuna e Obiliqit} **shpërblen** me kontratë " N Grup i Operatorëve Ekonomik AOME SH.P.K.: Ndërmarrje Tregtare Shërbyese TINI, Gjeravica. 10000, KOLOVICE ne vlere totale te ofertës {253000,08€

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "AGRIUM" SH.P.K –Ferizaj

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 18 te RROUPP-se pasi që gjatë hartimit te dosjes se tenderit ka vendosur kritere dhe kërkesa diskriminuese dhe në të njëjtën kohë favorizuese për OE te caktuar.Kërkesa 1

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 1"*Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 150.000,00 €*"

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: *"Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve".*

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa ***"Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve",*** *është jo shumë e qartë dhe mund të sqarohet më mirë, e ku në vend të kufizimit me shprehjen* ***"kontrata",*** *mendoj se duhet të shënohet:* ***Të dëshmuara me referenca apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve të***

natyrës së kontratës ose të ngjashme".

Në nenin 18.9 të RRUOPP-së, thuhet: "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE-ve, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 3 "*Të ketë së paku 4 punëtorë për realizim të kontratës*"

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: "*Lista e të punësuarve e paraqitur ne ATK ne tre muajit e fundit bashkë me përshkrimin e shkurter te vendit te punës. përshkrimi i shkurtër i vendit të punës për stafin e rregullt , për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt*"

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa nuk paraqet diskriminim për ansjë OE ndërsa sa i përket nevojes së përcaktimit të kësaj kërkese nga ana e AK-së,eksperti vlersonë që është kompetenc ligjore e AK-së të përcaktoj kërkesat sipas dispozitave të Nenit 27 të LPP-së dhe RROUP.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: **Kërkesa 4** "***Të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike 1 kamion të tonazhit deri 5 ton pesha ngarkuese***".

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: "*Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet te dëshmohet me kontratë*".

Pas analizës së kërkesës me numër rendor 4 ekperti shqyrtues sqaron se kërkesa aktuale është e definuar jo mire për OE, andaj do të duhej të qartësohet më mire. Si p.sh "*Të ketë në pronësi ose në posedim kamion transportues me peshë ngarkuese prej X deri X ton, në mënyre që të kenë mundësi pjesëmarrje më shumë OE*".

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Kërkesa 5 "*OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te ketë pikën e shpërndarjes së furnizimeve në qytetin e Prizrenit ose 5 km larg Prizreni* ".

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është: "*OE i cili do të shpërblehet me kontratë duhet te na sjell deklaratën e selisë per piken e shpërndarje së furnizimit* ".

Duke pas parasysh që kontrata ka të bëjë me furnizim dhe liferimi për këtë aktivitet të prokurimit mund të bëhet pa pasur nevoj të ketë depo apo pikë në qytetin e Prizrenit apo 5 klm larg Prizrenit sepse liferimi mund të bëhet nga secili cep i Kosovës në një afat kohorë mesatarishtë 2 orë.
Eksperti shqyrtues mendon se duhet të largohet kjo kërkesë në mënyrë që të krijohen më shumë oferta dhe të mos ketë diskriminim.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

OE ankues pretendon se ka qenë e pa nevojshme dhe nuk do të duhej që AK të kërkojë që OE ti paraqesin mostrat për kontinjer,si dhe perdorimi i markes së caktuar nga AK për OE është diskriminuese dhe favorizon kompani të caktuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: **Kërkesa 6** "*OE qe ofertojnë duhet ti sjellin mostrat me shenjat e OE para hapjes së ofertave ne KRM "Ekoregjion" ne Prizren –rruga Tahir Sinani nr*".

Pas analizës së Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me këtë kërkesë, eksperti shqyrtues sqaron se është e drejtë e AK-së që OE-ve të ju kërkojë që ti prezentojnë mostrat e produkteve dhe kjo nuk paraqet diskriminim, mirëpo eksperti shqyrtues sqaron se sa u përket emërtimit të prodhuesve të caktuar AK nuk do të duhej që të kërkoj produkt me emer të markës së caktuar të prodhuesit sepse kjo paraqet diskriminim dhe favorizim të ndonjë OE pjesëmarrës.

Në nenin 20.4 të RROUP thuhet:
Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Duke marrë parasyshë përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës,shqyrtim të pretendimeve ankimore të OE ankues analizë konkrete dhe dokumentacion të lëndës,eksperti shqyrtues e sheh ankesen e OE ankues sit të bazuar,duke sugjeruar Autoritetin Kontraktues të bëjë korigjimet e duhura përkitazi me dispozitat e LPP-së dhe RROUP.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të bëhen ndryshimet e duhura, të njoftohen palët me ndryshimet dhe të vazhdohet më tutje me aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues	- **KK PRIZREN**
Panelit Shqyrtues	- OSHP
OE ankues	- OE **"AGRIUM" SH.P.K –Ferizaj**